



| | | | |
|--|------------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranimi / Doretuar Primeni / Protolo Received / Delivery | 28.09.2023 | 3 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit | Nr. Prot. /i Prot. Prot. No. | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIPNSHCK | 6287 | 2023 | 1/7 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1048/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1048/2023 të datës 01.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted]

[redacted] kundër Vendimit me Nr.prot: 705 të datës 18.07.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1048/2023 e datës 01.08.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.prot:705 i datës 18.07.2023 i Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore e Kosovës.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke bërë kompensimin e pagës për ankuesin në vlerën prej 50% të pagës prej datës 08.03.2013 deri më datë 14.07.2016 të ndaluar sipas Vendimit me Nr.prot:69 të datës 08.03.2013 për pezullim parandalues, dhe kompensimin e pagës së plotë prej momentit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës përkatësisht prej se është bërë i plotfuqishëm Vendimi me Nr.10/2016 i datës 14.07.2016 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore e Kosovës, deri në ditën e kthimit në vendin e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Me Vendimin me Nr.Prot:69 të datës 08.03.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës ankuesi i punësuar në pozitën Inspektor Tatimor është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës deri në vendimin përfundimtar të gjykatës. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.932/13 të datës 27.06.2016 ka shpall fajtor ankuesin lidhur me veprën penale për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit zyrtar.

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës bazuar në aktgjykimin e lartcekur, më datë 30.06.2016 ka parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit pranë Komisionit Disiplinor. Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës më datë 14.07.2016 ka nxjerr Vendim Nr. 10/2016 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore ndërprerjeje e marrëdhënies së punës.

Kundër Aktgjykimit PKR.nr.932/13 pala mbrojtëse e ankuesit ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PAKR.nr.459/2016 të datës 27.07.2016 lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.630/16 të datës 22.08.2022 është liruar nga akuza ndërsa ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin PAKR.nr.501/22 të datës 29.12.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda.

Ankuesi me datë 18.01.2023 ka parashtruar kërkesë në Administratën Tatimore të Kosovës për kthim në vendin e punës, ndërsa sipas Vendimit me Nr. Prot:385 të datës 30.03.2023 të Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës është kthyer në vendin e punës duke ju lëshuar Akt Emërimi me nr.prot.1978 datë 31.03.2023 në pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor".

Ankuesi më datë 12.04.2023 ka parashtruar kërkesë me Nr.prot: 1615/06 në Administratën Tatimore të Kosovës përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e të gjitha pagave, shtesave, mbushjeve të telefonit, pagat jubilarë prej kohës së suspendimit deri në ditën e lëshimit të akt emërimit. Njësia e Burimeve Njerëzore përmes emailit të datës 17.05.2023 ka njoftuar ankuesin që është bërë kalkulimi i kompensimit vetëm për periudhën sa keni qenë të pezulluar dhe është dërguar për pagesë ndërsa për periudhën sa keni qenë i larguar nga puna nuk kemi gjetur bazë ligjore për realizimin e kompensimit. Ankuesi lidhur me këtë ka kërkuar vendimin për kompensim, mirëpo është njoftuar se për këtë çështje ka marr përgjigje dhe mund të ndjek rrugët ligjore.

Ankuesi kundër njoftimit të datës 17.05.2023, më datë 24.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4395/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 01.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 23.06.2023 ka nxjerr Vendim A.nr.770/2023 me të cilin ka detyruar Drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës që të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesi.

Zëvendësuesi i Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës më datë 18.07.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. port: 705 me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin nuk ka bazë ligjore për kompensim për kohën sa ka qenë i larguar nga puna.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.prot: 705 të datës 18.07.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore e Kosovës, më datë 01.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5470/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5470/2023 të datës 01.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. port: 705 të datës 18.07.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore e Kosovës; Vendimin A.nr.770/2023 të datës 23.06.2023 të Këshillit; Ankesën me numër protokolli 4395/2023 të datës 24.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin e datës 31.03.2023 të ankuesit; Vendimin me Nr.Prot: 385 i datës 30.03.2023; Njoftimin e datës 17.05.2023 për ankuesin nga Kërkesën e ankuesit përmes emailit e datës 17.05.2023; Përgjigjen përmes emailit e datës 18.05.2023 nga V.S për ankuesin; Aktgjykimin PKR.nr.630/16 i datës 22.08.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Aktgjykimin PAKR.nr.501/22 i datës 29.12.2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda; Kërkesën për përgjigje në ankesë datës 30.05.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 01.06.2023; Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 11.05.2023; Kërkesën me Nr. Prot: 1625/06 e datës 12.04.2023 dhe 18.01.2023 e ankuesit; Vendimin me Nr. 10/2016 i datës 14.07.2016 i Komisionit Disiplinor; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 30.06.2016; Vendimin me Nr. Prot: 69 i datës 08.03.2013 për pezullim parandalues; Lajmërim i pezullimit parandalues i datës 08.03.2013.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.prot:705 të datës 18.07.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore e Kosovës, pretendon që ky vendim është nxjerr në

kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke kërkuar që të bëhet kompensimi i pagës nga dita e pezullimit deri në ditën e kthimit në vendin e punës.

Kolegji i Këshillit, bazuar në provat materiale të lëndës, konstaton se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.630/16 të datës 22.08.2022 ka liruar nga akuza ankuesin ndërsa ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin PAKR.nr.501/22 të datës 29.12.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, si rezultat i kësaj ankuesi është kthyer në vendin e punës sipas Vendimit me Nr.prot: 385 të datës 29.03.2023 dhe atë në pozitën "*Inspektor i Mesëm Tatimor*".

Duke marr parasysh faktin se Aktgjykimit PKR.nr.932/13 të datës 27.06.2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes të cilit ankuesi është shpall fajtor lidhur me veprën penale për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit zyrtar, nuk është bërë i plotfuqishëm ngase pala ankuese përmes përfaqësuesit të tij ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës ndërsa me Aktgjykimin PAKR.nr.459.2016 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda të datës 27.07.2016 lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, atëherë Kolegji i Këshillit, marr për bazë legjislacionin e aplikueshëm në atë kohë respektivisht marr për bazë Ligjin N. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 63 paragrafi 3 është përcaktuar se: "*3. Në rast të inicimit të procedurës penale kundër nëpunësit civil për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të mandatit të tij/saj administrativ, që mund të rezultojë në krijimin e kushteve për ngritjen e padisë kundër nëpunësit civil, të gjitha procedurat disiplinore lidhur me rastin nuk mund të iniciohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente*", si rezultat i kësaj veprimet procedurale ndaj ankuesit respektivisht kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 30.06.2016 e parashtruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës dhe nxjerrja e Vendimit me Nr. 10/2016 të datës 14.07.2016 nga ana e Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, janë veprime që bien ndeshë dhe janë në kundërshtim të plotë me nenin e potencuar si më lartë (63.3) ngase nuk kemi pasur vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me rastin konkret ndërsa ende pa u vendosur përfundimisht me vendim gjyqësor janë ndërmarr veprimet juridike në dëm të palës ankuese, ngase nuk është dashur të ndërmerret asnjë veprim procedural deri në vendosjen përfundimtare respektivisht është dashur të kihet parasysh edhe dispozita e nenit 69 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, ku ishte përcaktuar se: "*2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata*", sepse institucioni punëdhënës ende pa u vendosur përfundimisht sipas vendimit të gjykatës ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës duke mos pasur parasysh nocionin e prezumimit të pafajësisë që është një nga institutet bazë këso raste .

Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh që Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.630/16 të datës 22.08.2022 ka liruar nga akuza ankuesin për arsye se nuk është provuar se të akuzuarit(duke përfshi edhe ankuesin në këtë rast) kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen ndërsa ky aktgjykim është vërtetuar me Aktgjykimin PAKR.nr.501/22 të datës 29.12.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, atëherë duke pasur parasysh faktin se ndërprerja e marrëdhënies së punës së

ankuesit nga komisioni disiplinorë i Administratës Tatimore të Kosovës përmes vendimit Nr.10/2016 të datës 14.07.2016 është bërë bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Krime të Rënda PKR nr.932/13 të datës 27.06.2016, përkundër që ky aktgjykim nuk ishte i plotfuqishëm dhe se i njëjti aktgjykim ishte prish me Aktgjykimin PAKR.nr.459.2016 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda të datës 27.07.2016 dhe lënda ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda përmes Aktgjykimit PKR.nr.630/16 të datës 22.08.2022 ankuesin ka liruar nga akuza për faktin se nuk ishte provuar fajësia, po ashtu përmes aktgjykimit PAKR.nr.501/22 të datës 29.12.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda ishte vërtetuar Aktgjykimi lirues PKR.nr.630/16 i datës 22.08.2022 që ndërlihdet me ankuesin, e i cili aktgjykim ishte zbatuar nga Administrata Tatimore e Kosovës përmes vendimit me nr.385 të datës 30.03.2023 me që rast ankuesi ishte kthyer në vendin e punës Inspektor Tatimor nga data 01.04.2023 dhe bazuar në dispozitat e nenit 69 paragrafi 3 ndërlihdur me nenin 69 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, ishte e përcaktuar se: "3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse në procedurë penale nuk është vërtetuar me vendim të formës se prerë se ankuesi ka kryer veprë penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit zyrtar, atëherë përveç të drejtës për tu kthyer në vend të punës ashtu si ishte paraparë në dispozitën e nenit 63 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 dhe 5.2,ku parashihej:"5.Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm:5.1 ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues;5.2 asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër nëpunësit civil pas shpalljes i/e pafajshëmose përjashtimit nga një procedurë penale", ankuesit i takon edhe e drejta për kompensim material në kuptim të dispozitave të potencuara si më lartë.

Sa i përket vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht ligjshmërisë së Vendimit me Nr. prot: nr.705 të datës 18.07.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore e Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se mbi bazë të këtij vendimi konstatohet se ankuesit nuk ka mundur t'i realizohet as kompensimi për periudhën 2013-2016 ngase i njëjti ka kërkuar pushim pa pagesë dhe e njëjta kërkesë i është miratuar, kështu që meqenëse se sipas këtij vendimi nuk i është njohur e drejta e kompensimit nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin e tij në vendin e punës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr në konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe në dëm të palës ankuese duke u shkelur edhe ligji material, ngase sipas dispozitave ligjore të lartcekura ankuesit i takon kompensimi i pagave të papaguara, sepse sipas Kolegjit të këshillit nuk mund të dëmtohet një palë në procedurë për shkak të veprimeve administrative që nuk janë në harmoni me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje. Kështu që ky vendim i atakuar me këtë ankesë është nxjerr në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1, nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "neni 6 paragrafi 1.Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit", "neni 8 paragrafi 1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1048/2023, datë 28/09/2023

Avdyl BEKTESHI

Avdyl Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.